



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 40.2 nën c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenit 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës me kërkesën e Drejtorisë së Financave, Ekonomi dhe Zhvillim, përmes zyrës së kryetarit me datë: 09.06.2021 me nr.01-451-25200, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VII-të të rregullt për vitin 2021, të mbajtur me datën 30.07.2021 mori këtë:

V E N D I M

Për

ndarjen e mjeteve buxhetore për OJQ-et

1. Ndahen mjete buxhetore nga kategoria e subvencioneve në vlerë prej: 50.000,00€, me qëllim të mbështetjes financiare për OJQ-et, ndarja e të cilave do të bëhet përmes thirrjes publike duke respektuar kushtet dhe kriteret e Rregullores 04/2017 të Ministrisë së Financave dhe Transfereve
2. Duke u bazuar në kërkesat dhe nevojën e madhe për mjete financiare të OJQ-ve, Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit Kumunal që vlera prej 50,000,00€ të sigurohet nga kategoria e subvencioneve, nga programet buxhetore si në vijim:
3. Zyra e Kryetarit –Programi buxhetor 16018 në vlerë prej: 8,000.00€,
Drejtoria e Bujqësisë –Programi buxhetor 47018 në vlerë prej: 35,000.00€,
Drejtoria e kulturës –Programi buxhetor 85018 në vlerë prej 2,000.00€,
Drejtoria e arsimit – Programi buxhetor 92090 në vlerë prej 5,000,00€.
TOTALI 50.000,00€.
4. Për mjetet të cilat ndahen sipas nenit II të këtij Vendimi, nuk do të ketë lëvizje-transfer apo ri-alokim të mjeteve, ato do të mbesin nëpër programet përkatëse buxhetore prej nga do të ekzekutohen edhe pagesat pas thirrjes për aplikim të OJQ-ve dhe vlerësimit nga ana e Komisionit vlerësues për shumën e mjeteve që do t'u ndahen OJQ-ve.
5. Arsyeshmëria e këtij Vendimi, qëndron në faktin se OJQ-të në Komunën tonë kanë nevojë për përkrahje financiare shtesë për zhvillimin e aktiviteteve dhe arritjen e rezultateve me të mira, përndryshe një numër i OJQ-ve pa këtë mbështetje nuk do të mund të ekzistojnë.
6. Vendimi hyn në fuqi me miratim nga Kuvendi i Komunës dhe me nënshkrim nga Kryesuesi i Kuvendit.

Njoftohen:

- MPL
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi;

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06.25324 /21
Klinë, me 03.08 /21



**Kryesuesi,
Fadil GASHI**